



VENDIMI I PAPRANUESHMËRISË

Data e miratimit: 23.02.2011

Nr. i rastit 2010-15

Faton Sefa

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 23 shkurt 2011 me anëtarët e pranishëm si në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, Kryesues i Panelit
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare
Z. Francesco FLORIT, anëtar

Asistuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, paraqitur në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Koncepti Llogaridhënës i EULEX-it i datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është regjistruar me 28 shtator 2010.

II. FAKTET

Parathënie

2. Parashtruesi i ankesës ishte punësuar si drejtor teknik nga Hidrosistemi “Radoniqi” që nga viti 1982. Kompania ndërkombëtare “Gelsenwasser” mori përsipër menaxhimin e kompanisë në vitin 2002. Më 18 gusht 2006 parashtruesit të ankesës iu ishte shkëputur kontrata e punës me efekt të menjëhershëm, supozohet për faktin se “ai nuk kishte arritur t’i zvogëlonte humbjet e ujit”.
3. Me 24 gusht 2006 parashtruesi i ankesës ka kërkuar shqyrtimin e shkëputjes së kontratës së tij. Me 25 gusht 2006 Drejtori Menaxhues i kompanisë ka kërkuar nga parashtruesi i ankesës që menjëherë ta kthente telefonin mobil, që ishte pronë e kompanisë.
4. Më 30 gusht 2006 parashtruesi i ankesës ka dorëzuar një ankesë kundër vendimit nr. 2660 të marrë nga Komisioni Disiplinor me 25 gusht 2006 (vendimi ekzistues nuk është sjellë nga parashtruesi i ankesës). Ankesa ishte hedhur poshtë me datën 21 shtator 2006.

Procedurat para Institucionit të Ombudspersonit

5. Parashtruesi i ankesës ka dorëzuar një ankesë tek Institucioni i Ombudspersonit me 28 shtator 2007. Kompanisë i është kërkuar ofrimi i informatave shtesë me 19 maj 2008. Nuk është dhënë asnjë hollësi tjetër në procedurë.

Procedura civile

6. Parashtruesi i ankesës ka paraqitur një rast civil tek Gjykata Komunale e Gjakovës në vitin 2008. Me 20 mars 2009 Gjykata Komunale ka konstatuar se ai ishte larguar nga puna në mënyrë të paligjshme dhe se ai duhet të rikthehej në pozitën e tij të mëparshme apo ekuivalente brenda 8 ditëve nga koha kur vendimi të merrte formën përfundimtare.
7. Më 9 shkurt 2010 Gjykata e Qarkut të Pejës ka vendosur rreth kësaj çështje, me sa duket në të mirë të kompanisë. Nuk është ofruar asnjë vendim. Parashtruesi i ankesës ka kërkuar që Gjykata Supreme e Kosovës ta vërtetoj vendimin e mëhershëm nga Gjykata Komunale e Gjakovës. Vendimi përfundimtar i Gjykatës Supreme nuk dihet.

Informata shtesë

8. Parashtruesi i ankesës ka paraqitur ankesa tek Administrata e UNMIK-ut, Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut i UNMIK-ut, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, etj. Nuk është ofruar ndonjë dokument tjetër.

III. ANKESAT

9. Parashtruesi i ankesës pretendon se ai ishte larguar nga puna në mënyrë të padrejtë dhe ai dëshiron që të rikthehet në pozitën e vet të mëparshme dhe të kompensohet për humbjet e tij financiare.

IV. LIGJI

10. Para shqyrtimit të ankesës për bazueshmërinë e saj, Paneli duhet të vendos se a ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriterin për pranueshmëri të ankesës të përcaktuar me Rregulloren 29 të Procedurës së Punës.
11. Sipas Rregullores 25, paragrafi 1 i Rregullores së Punës, Paneli mund të shqyrtoj vetëm ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut të kryera nga EULEX-i, gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv.
12. Çështje e ngritur në këtë ankesë ka të bëjë me një kontest privat ligjor midis parashtruesit të ankesës dhe punëdhënësit të tij të mëhershëm "Hidrosistemi Radoniqi". Nuk është treguar apo as edhe argumentuar se EULEX-i ka qenë i përfshirë në çfarëdo kapaciteti në rastin civil të parashtruesit të ankesës.
13. Rasti i tanishëm nuk bie brenda mandatit ekzekutiv të Gjykatësve të EULEX-it, që sipas Ligjit të Juridiksionit, Përzgjedhja e Rastit dhe Caktimi i Rastit të Gjykatësve dhe Prokurorëve të EULEX-it (Ligji Nr. 03/L-053) në rastet civile (neni 5) kufizohet në:
 - a) rastet që bien brenda juridiksionit të Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës rreth çështjeve që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, përfshirë rastet që janë referuar tek ndonjë gjykatë tjetër në përputhje me ligjin e zbatueshëm;
 - b) rastet që bien brenda juridiksionit të çfarëdo gjykate të Kosovës lidhur me ankesat ndaj vendimeve të Komisionit të Kërkesave Pronësore të Kosovës sipas ligjit të zbatueshëm;
 - c) Secili rast civil i ri apo në pritje që ka të bëjë me pronësi, kur ekzistojnë kushte specifike.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, njëzëri konstaton se nuk ka juridiksion për ta shqyrtuar ankesën e tanishme, konstaton se ankesa është e pabazuar në Nenin 29 (d) të Rregullores së Punës së vet, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Antonio BALSAMO
Kryesues i Panelit